

VENDIM
Nr. 143, datë 15.8.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK, PËR VENDOSJE TË HIPOTEKËS
MBI PASURITË E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË
GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE, OESTERREEICHISCHE
ENTWICKLUNGBANK AG**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 119, datë 21.7.2016, pika 1.3 e licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien si garanci hipotekare të aseteve të shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, germa “a”** (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); **“b”** (veprimtaria e licencuar); **“c”** (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve); **“e”** (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); **“f”** (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); **“g”** (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar); **“j”** (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me **nenin 7, pika 1, germën “d”** (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); **“h”** (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen) dhe **“i”** (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit), do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për vendosje të Hipotekës mbi pasuritë e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në favor të Green For Growth Fund Southeast Europe, Oesterreeichische Entwicklungsbank AG.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti